# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera*

*Ministry of Finance, Labour and Transfers*

---

# MANUAL PËR LICENCIMIN E ORGANIZATAVE JOQEVERITARE DHE SUBJEKTEVE TJERA JURIDIKE PRIVATE QË OFROJNË SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE

Prishtinë, Mars 2021

# PËRMBAJTJA

1. HYRJE ..... 4

2. LICENCIMI I ORGANIZATAVE JOQEVERITARE DHE SUBJEKTEVE TJERA JURIDIKE PRIVATE QË OFROJNË SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE ..... 5

2.1 Hyrje ..... 5

2.2 Pse bëhet licencimi i organizatave joqeveritare dhe subjekteve tjera juridike private që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare ..... 5

2.3 Subjektet juridike që mund të ofrojnë shërbime sociale ..... 6

2.4 Cilat kritere duhet ti plotësojnë subjektet juridike për licencim ..... 7

***a) Të jetë i regjistruar si person juridik*** ..... 7

***b) Në statutin e personit juridik të parashihen aktivitetet në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare*** ..... 8

***c) Personi juridik duhet të ketë në dispozicion minimumin e nevojshëm të ofruesve individual të shërbimeve sipas llojit të shërbimeve*** ..... 8

***d) Personi juridik nuk duhet të jetë në procedurë falimentimi apo shuarje*** ..... 9

***e) Personi juridik të mos jetë nën hetime;*** ..... 9

***f) Personi Juridik të ketë të miratuar një biznes plan që mbulon periudhën e ardhshme tre (3) vjeçare;*** ..... 10

***g) Personi juridik ka marrëveshje bashkëpunimi mbi zbatimin e projekteve në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare;*** ..... 10

***h) Personi juridik ka afarizëm pozitiv në vitin e fundit fiskal;*** ..... 11

***j) Nuk ka detyrime tatimore ndaj ATK-së apo ka marrëveshje për shlyerje të borxheve*** ..... 11

***i) Ka përvojë dhe bashkëpunim me partner të fushës së shërbimeve sociale dhe familjare*** ..... 11

**2.5. Kriteret Teknike që duhet të përmbushin ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare** ..... 11

***a. Personi juridik duhet të posedoj zyre për ushtrimin e aktivitetit*** ..... 11

***b. Personi juridik duhet të posedoj ambiente të mjaftueshme, të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve dhe zhvillimin e aktiviteteve profesionale dhe rekreative për klientë*** ..... 12

***c) personi juridik duhet të posedojë pajisje adekuate për trajtimin dhe ofrimin e shërbimeve për klientët*** ..... 12

**2.5 Si bëhet aplikimi për licencim të personave juridik** ..... 13

***2.6 Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit për licencim të personave juridik*** ..... 13

***2.7 Roli, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit për Licencim*** ..... 15

***2.8. Roli Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit të ankesave*** ..... 15

***2.9. Vazhdimi i licencës*** ..... 15

***2.10 Revokimi i licencës*** ..... 16

1. ANEKS – MODELE TË FORMULARËVE DHE SHKRESAVE TJERA ..... 36

**Shtojca 1: Lista e Llojeve të shërbimeve për Licencim të organizatave jo qeveritare dhe subjekteve tjera juridike private me standardet minimale sa i përket ofruesve**

**individual të licencuar të shërbimeve sociale dhe familjare për një qendër apo shtëpi me bazë në komunitet**........................................................................ **Error! Bookmark not defined.**

Shtojca 2: Formular i Kërkesës për Licencim për Ofrim të Shërbimeve Sociale dhe Familjare për OJQ dhe Subjektet Tjera Juridike ........................................................................................................ 36

Shtojca 3: Model i Rregullave të Punës së Komisionit për Licencim................................................. 46

Shtojca 4: Model i Deklaratës së paanësisë, konfidencialitetit dhe shmangies së konfliktit të interesit .......................................................................................................................................... 50

Shtojca 5: Model i formularit për Vlerësim të aplikacionit të Personit juridik që ka aplikuar për licencim............................................................................................................................ 51

# 1. HYRJE

Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare[1] përbën bazën ligjore kryesore për ofrimin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare në Republikën e Kosovës. Me këtë Ligj janë përcaktuar edhe detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, duke përfshirë Ministrinë e Punës dhe Mirëqenie Sociale, Departamentin e Politikave Sociale dhe të Familjes, Komisionin për Licencim dhe Komisionin e Ankesave. Krahas kësaj, procedurat e licencimit për ofruesit në nivel institucional janë përcaktuar me legjislacionin sekondar që buron nga Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare.

Ndonëse, kriteret dhe procedurat e detajuara janë përcaktuar me legjislacionin sekondar të nxjerrë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, legjislacioni sekondar, ka përcaktuar qartë që detajet shtesë, duke përfshirë shpjegime shtesë për procedurat, kriteret, rolin dhe detyrat e mekanizmave të Ministrisë, do të ofrohen përmes Manualit për licencim të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare. Manuali në të njëjtën kohë do të ofrojë lehtësi në zbatimin e legjislacionit për shërbime sociale dhe familjare, përmes ofrimit të modeleve të formularëve të cilët do të lehtësojnë punën e mekanizmave institucionale në procesin e licencimit, por do të ndihmojnë edhe vetë ofruesit e shërbimeve sociale në procesin e aplikimit dhe licencimit të tyre për ofrim të shërbimeve sociale dhe familjare.

Manuali është një dokument dinamik, dhe mund të plotësohet në çdo kohë nga Ministria, për të reflektuar nevojën për sqarime shtesë sipas nevojës. Manuali është organizuar si më poshtë:

- Licencimi i organizatave joqeveritare dhe subjekteve tjera juridike private që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare;
- Anekse – modele të formularëve dhe shkresave tjera.

Krahas shpjegimeve të përfshira në pjesën tekstuale të Manualit, anekset e tij, që përbëhen nga modele të formularëve të aplikueshëm në procesin e licencimit, përbëjnë njërën nga pjesët më të rëndësishme të Manualit, dhe të njëjtat, ofrojnë shpjegime dhe lehtësira shtesë për mekanizmat institucional dhe vetë aplikuesit në procesin e licencimit.

[1] Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare, i datës 21 prill 2005 (GZ nr. 12, datë 01.05.2007), i Plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare (GZ. Nr.5 datë 05 prill 2012). I qasshëm në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2447

# 2. LICENCIMI I ORGANIZATAVE JOQEVERITARE DHE SUBJEKTEVE TJERA JURIDIKE PRIVATE QË OFROJNË SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE

## 2.1. Hyrje

Licencimi i ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare në nivel institucional është përcaktuar me Ligjin Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare. Ndër të tjera, në nenin 2, paragrafin 2.3, theksohet se: "*Komunat ose organizatat e tjera qeveritare dhe joqeveritare, përfshirë edhe ndërmarrjet private, mund të ofrojnë shërbime sociale dhe familjare.*" Ndërsa i njëjti Ligj i mundëson Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të përcaktojë se ku, si dhe kush i kryen këto shërbime.[2] Rrjedhimisht, bazuar në dispozitat e Ligjit, Ministria është përgjegjëse të përcaktojë dhe specifikojë kriteret e nevojshme për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, përmes akteve nënligjore, manualëve dhe procedurave të nevojshme për këtë qëllim.

Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 02/2020 për licencimin e organizatave jo qeveritare dhe subjekteve juridike private që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, ka përcaktuar më tutje në detaje të gjithë procedurën e licencimit të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare për këto subjekte. Ky Udhëzim ka përcaktuar të gjithë procesin e licencimit, duke përfshirë procedurën e aplikimit, kriteret që duhen plotësuar nga ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare, dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar për të dëshmuar përmbushjen e këtyre kritereve. Gjithashtu, aty është rregulluar edhe procedura për shqyrtimin e kërkesës nga ana e komisionit për licencim, procedurat e ankesës dhe detyrat e institucioneve dhe mekanizmave të Ministrisë në procesin e licencimit të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare.

## 2.2. Pse bëhet licencimi i organizatave joqeveritare dhe subjekteve tjera juridike private që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare

Licencimi i organizatave joqeveritare dhe subjekteve tjera juridike private që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, është një proces që ka për qëllim të sigurojë përmbushjen e kritereve ligjore dhe teknike për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Ministria është përgjegjëse të përcaktojë dhe specifikojë standardet profesionale të resurseve për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, që duhet të përmbushen nga ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare, duke përfshirë edhe krijimin e mekanizmave që sigurojnë arritjen e tyre.[3] Kjo përfshin edhe specifikimin e llojit dhe numrit të personelit profesional që duhet të punësohet nga ana e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare. Ministria përmes legjislacionit sekondar, por

[2] Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Neni 2, Par. 2.3. https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2447
[3] LSHSF, Neni 2, Par. 2.5.

edhe udhëzuesve dhe procedurave të përcaktuara nga Ministria, ka për qëllim të sigurohet që secili ofrues i shërbimeve sociale dhe familjare, i plotëson kriteret minimale të përcaktuara me standardet e miratuara nga Ministria për secilin lloj të shërbimeve sociale.[4] I gjithë procesi ka për qëllim të sigurojë që subjektet që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, të ofrojnë një standard të përcaktuar në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Prandaj, në funksion të krijimit të një mjedisi të rregulluar për të ushtruar veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare nga ana e OJQ-ve dhe subjekteve tjera juridike private, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ka përgatitur ***Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr. 02/2020 për Licencimin e Organizatave Joqeveritare dhe Subjekteve tjera Juridike Private që ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare***. Përmes të cilit, në kuadër të kritereve të përcaktuara me Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare, janë specifikuar kriteret dhe procedurat për licencimin e këtyre ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare. Kurse në këtë pjesë të Manualit janë dhënë sqarime shtesë për procesin, procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm.

## 2.3. Subjektet juridike që mund të ofrojnë shërbime sociale

Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare mundëson që, subjektet juridike të cilat ushtrojnë veprimtari në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, të mund të licencohen për ofrim të shërbimeve sociale dhe familjare. Në linjë me kërkesat e Ligjit për Shërbime Sociale edhe Familjare, Udhëzimi Administrativ për Licencimin e Organizatave Joqeveritare dhe Subjekteve tjera Juridike Private që ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare, parasheh që të gjitha subjektet juridike të themeluara sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe ato të themeluar me Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, mund të ofrojnë shërbime sociale dhe familjare. Rrjedhimisht, të gjitha këto subjekte mund të aplikojnë për licencim në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Këto subjekte juridike, pavarësisht formës së organizimit të tyre, dhe për faktin se konsiderohen persona juridik, mund të licencohen për ofrim të shërbimeve sociale dhe familjare e këtu bëjnë pjesë:

*a) Shoqatat;*
*b) Fondacionet;*
*c) Institutet;*
*d) Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar;*
*e) Shoqëritë Aksionare;*
*f) Çdo formë tjetër, e personit juridik privat, e cila sipas ligjeve në fuqi konsiderohet person juridik;*

Për licencim, mund të aplikojnë edhe subjektet juridike me status të ndërmarrjes sociale, duke përfshirë edhe ato që mbajnë statusin për përfitim publik.
Pa siguruar licencën nga Ministria, asnjë subjekt nuk mund të ofrojë shërbime sociale dhe familjare.
Në secilin rast subjektet juridike duhet të plotësojnë kriteret për licencim të përcaktuara me ligj dhe me aktet nënligjore në fuqi.

[4] LSHSF, Neni 2, Paragrafi 2.6.

Personi juridik me licencë të nivelit lokal, mund të ushtrojë veprimtarinë për shërbimet sociale dhe familjare, për të cilat është licencuar në më së shumti në dy (2) komuna që kanë ndërlidhje administrative kufitare, ku personi juridik ka selinë dhe adresën për të cilën është licencuar. Nëse personi juridik planifikon të ushtrojë veprimtarinë për shërbime sociale dhe familjare për më shumë se dy (2) komuna, duhet të aplikojnë për licencë të nivelit nacional.

## 2.4. Cilat kritere duhet t'i plotësojnë subjektet juridike për licencim

Bazuar në nenin 5 të *Udhëzimin Administrativ për Licencimin e Organizatave Joqeveritare dhe Subjekteve tjera Juridike Private që ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare*, personi juridik duhet të plotësojë kriteret ligjore dhe teknike.

*Në kuadër të kritereve ligjore që duhet të plotësojë personi juridik, bëjnë pjesë:*

- *Të jetë i regjistruar si person juridik;*
- *Në statutin e personit juridik, të parashihen aktivitetet në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare;*
- *Të posedojë minimumin e nevojshëm të ofruesve individualë të shërbimeve, sipas llojit të shërbimeve;*
- *Të mos jetë në procedurë falimentimi apo të shuarjes;*
- *Të mos jetë nën hetime;*
- *Të ketë të miratuar një plan të biznesit, që mbulon periudhën e ardhshme tre (3) vjeçare;*
- *Të ketë marrëveshje bashkëpunimi mbi zbatimin e projekteve në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare;*
- *Të ketë afarizëm pozitiv në vitin e fundit fiskal;*
- *Të mos ketë detyrime tatimore ndaj ATK-së apo të ketë marrëveshje për shlyerje të borxheve;*
- *Të ketë përvojë dhe bashkëpunime me partnerë të fushës së shërbimeve sociale dhe familjare.*

*Duke pas parasysh rëndësinë e secilit nga këto kritere, në vijim janë elaboruar secila veç e veç:*

### *a) Të jetë i regjistruar si person juridik*

Sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës ekzistojnë disa forma të organizimit të personave juridik privat. Si shoqëri tregtare ekzistojnë dy forma të personave juridik: *Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar; shoqëria aksionare*. Ndërsa, sipas dispozitave të Ligjit për Lirinë e

Asociimit në organizata jo qeveritare të gjitha format e organizimit të OJQ-ve, konsiderohen persona juridik: *Shoqata; Fondacioni; Instituti*. Prandaj, para se të aplikojë për licencim në ofrimin e shërbimeve sociale në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, subjekti juridik duhet të regjistrohet në ndonjërën nga format e personit juridik. Nga aspekti formal, koha e regjistrimit nuk ka rëndësi për procesin e licencimit, por është me rëndësi që subjekti të jetë i regjistruar si person juridik në kohën e aplikimit për licencim. Prandaj, edhe personat juridikë të krijuar rishtazi, por edhe ato të krijuara më herët, mund të aplikojnë për licencë në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare. *Dëshmi e regjistrimit është certifikata e regjistrimit nga ARBK-ja apo nga DOJQ-ja, prandaj, Komisioni do të vlerësojë përmbushjen e këtij kriteri formal, bazuar mbi dokumentet e dorëzuara dhe mbi bazën e verifikimit të të njëjtave, duke iu qasur regjistrave publikë për subjektet juridike të regjistruara, në ARBK apo DOJQ.*

### *b) Në statutin e personit juridik të parashihen aktivitetet në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare*

Statuti i personit juridik është dokumenti kryesor qeverisës i personit juridik. Në statut është përcaktuar në mënyrë të qartë veprimtaria e personit juridik. Prandaj, edhe pse parimisht çdo person juridik privat mund të licencohet për ofrim të shërbimeve sociale dhe familjare, të drejtën për licencim do ta fitojnë vetëm ato persona juridikë që në statutin e tyre kanë të paraparë si fushë të veprimtarisë ndonjërën, apo disa nga fushat e ofrimit të shërbimeve sociale. Dispozitat ligjore dhe ato të udhëzimit administrativ, nuk ndalojnë personin që në kuadër të aktiviteteve të merret edhe me aktivitete tjera jashtë atyre të ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare, sidoqoftë, në fushën e veprimtarisë dhe aktiviteteve të personit juridik, shërbimet sociale dhe familjare duhet të zënë vend të konsiderueshëm. Prandaj, Komisioni për Licencim do të vlerësojë dispozitat e statutit, për të vlerësuar nëse aplikuesi me statutin e tij ka paraparë ushtrimin e veprimtarisë në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare. Rrjedhimisht, subjektet juridike që kanë për qëllim të licencohen në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, por të cilat në statutin e tyre nuk kanë të paraparë si fushë të veprimtarisë dhe aktiviteteve të tyre ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare duhet ti nënshtrohen ndryshimit të fushave të veprimtarisë në rast se synojnë që të aplikojnë për marrje të licencës në ndonjërën apo në disa nga fushat e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare. *Komisioni për Licencim do të analizojë dispozitat e statutit në fuqi të personit juridik, për të konstatuar nëse ky kriter përmbushet ose jo.*

### *c) Personi juridik duhet të ketë në dispozicion minimumin e nevojshëm të ofruesve individualë të shërbimeve, sipas llojit të shërbimeve*

Ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare nga një person juridik, është i pamundur në rast se subjekti nuk posedon kapacitete njerëzore adekuate për ofrimin e shërbimit të tillë. Prandaj, varësisht nga lloji i shërbimeve sociale, aplikuesi për licencë duhet të sigurojë dëshmi të personelit me përgatitje përkatëse për secilin lloj të shërbimeve që aplikon për licencim. Në këtë fazë të aplikimit për licencim, kërkohet kontratë (marrëveshje) valide pune me personelin e propozuar në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, përveç kësaj, aplikuesi duhet të

sigurojë një zotim me shkrim në formë të deklaratës nga ana individëve të kualifikuar dhe licencuar si ofrues individual në momentin e aplikimit për licencë të personit juridik, se ata do të punojnë/ofrojnë shërbimet profesionale për personin juridik që ka aplikuar për licencim. Numri i ofruesve individual është i përcaktuar në listën e publikuar nga Ministria, e cila është pjesë përbërëse e këtij Manuali dhe mund të përditësohet, duke përfshirë edhe futjen e shërbimeve të reja dhe numrit të kërkuar të ofruesve individual për secilin shërbim social dhe familjar.

Ofruesi individual i cili ka një kontratë pune me orar të plotë tek një person juridik joqeveritar dhe privat, mund të ofrojë shërbime dhe të angazhohet në subjekte tjera juridike me kontratë për shërbime të veçanta, por licenca e tij nuk do të mund të përdoret për licencim më shumë se tek një subjekt juridik që aplikon për licencë apo është i licencuar, ndërsa ofruesi individual i cili është në marrëdhënie pune në sektorin publik, mund të ofrojë shërbime dhe angazhohet në subjekte tjera juridike me kontratë për shërbime të veçanta, por licenca e tij nuk do të mund të përdoret për licencim më shumë se tek një subjekt juridik joqeveritar dhe privat, që aplikon për licencë apo është i licencuar.

*Për çdo ofrues të licencuar ofrues individual, personi juridik që aplikon për licencim do të sigurojë një kopje të certifikatës së licencës së ofruesit, kontratë valide të punës, si dhe zotimin e ofruesit individual në formë të një deklarate se ai/ajo do të ofrojë shërbime/punojë për personin juridik që ofron shërbime sociale dhe familjare. Zotimi do të përgatitet sipas formularit të bashkangjitur në aneksin e këtij manuali.*

### *d) Personi juridik nuk duhet të jetë në procedurë falimentimi apo shuarje*

Personi juridik që është në procedurë shuarje ose falimentimi nuk mund të licencohet si ofrues i shërbimeve sociale dhe familjare. Në rast të aplikimit nga ndonjë person juridik që është në procedurë falimentimi, komisioni për licencim do të refuzojë kërkesën për licencim. Ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare është një fushë e ndjeshme dhe në interes publik, prandaj, Ministria ka për detyrë të sigurojë që përfituesit e shërbimeve sociale të mos dëmtohen si rezultat i çfarëdo situate që ndërlidhet me falimentimin apo shuarjen e personit juridik që ofron shërbime sociale dhe familjare. Rrjedhimisht, me rastin e licencimit, komisioni për licencim do të sigurohet që personi juridik nuk është në procedurë falimentimi apo shuarje. *Për të dëshmuar se nuk është në procedurë falimentimi personi juridik do të sigurojë si pjesë e dosjes aplikuese për licencim një vërtetim nga gjykata kompetente që personi juridik nuk është në procedurë falimentimi. Për të dëshmuar se nuk është në procedurë të shuarjes vullnetare, nuk kërkohet të dorëzoj ndonjë dokument, por dehet të plotësoj të dhënat në formularin e kërkesës për licencim, të cilat do të konsiderohen si deklaratë e personit përgjegjës se personi juridik nuk është në procedurë të shuarjes vullnetare.*

### *e) Personi juridik të mos jetë nën hetime;*

Ministria nuk do t'i licencojë subjektet juridike që janë nën hetime për shkak të një procedure të kryerjes së veprës penale të personit juridik, konform dispozitave ligjore për përgjegjësinë penale të personave juridikë. Për të dëshmuar përmbushjen e kësaj kërkese, personi juridik do

të paraqesë si pjesë e dosjes për licencim edhe certifikatën nga gjykata kompetente në emër të personit juridik, me të cilën vërtetohet që personi juridik nuk është në procedurë nën hetime.

***f) Personi juridik të ketë të miratuar një plan të biznesit që mbulon periudhën e ardhshme tre (3) vjeçare;***

Me qëllim të lehtësimit të procesit të licencimit të subjekteve juridike në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, në aneks të këtij Manuali është paraqitur një model i planit të biznesit të cilin duhet ta dorëzojnë subjektet që aplikojnë për licencim. Ky plan biznesi ndër të tjera duhet të përmbajë këto informacione se i përket personit juridik dhe shërbimeve sociale dhe familjare, që personi juridik synon të ofrojë gjatë periudhës tre vjeçare të zbatimit të këtij plani të biznesit:

- *Misioni i personit juridik,*
- *Objektivat sociale dhe familjare,*
- *Informata për strukturën e organizatës,*
- *Njerëzit/plani i punësimit,*
- *Analiza e tregut të shërbimeve sociale për të cilat ka aplikuar për licencim,*
- *Shërbimet dhe aktivitetet si dhe plani i zgjerimit të tyre në të ardhmen,*
- *Vlerësimi dhe vlerësimi i ndikimit,*
- *Rreziqet,*
- *Financat,*
- *Informacione tjera të cilat personi juridik e konsideron të nevojshme t'i paraqesë.*

Plani i biznesit është një plan dinamik, dhe mund të plotësohet dhe ndryshohet në baza vjetore për të adresuar ndryshimeve eventuale.

***g) Personi juridik ka marrëveshje bashkëpunimi mbi zbatimin e projekteve në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare***

Për personat juridikë që aplikojnë për herë të parë për licencim, nuk është e domosdoshme të sigurojnë marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e projekteve në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare. Sidoqoftë, kjo nuk e përjashton të drejtën e personit juridik që të paraqesë zotime nga institucionet apo subjektet e tjera se në të ardhmen pas licencimit, subjekti do të implementojë projekte dhe do të ofrojë shërbime në partneritet me subjektin që ka aplikuar për licencim. Në rastin, e aplikimit për rilicencim nga ana e personit juridik, siç parashihet me dispozitat e Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Organizatave jo Qeveritare dhe Subjekteve Juridike Private që ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare, subjekti juridik duhet t'i dorëzojë marrëveshjet e tilla me subjektet e tjera. Me rastin e aplikimit do të duhet të dorëzohet një kopje e marrëveshjes së tillë të bashkëpunimit mbi zbatimin e projekteve në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare. Kjo mund të përfshijë marrëveshjet ekzistuese në fuqi, apo marrëveshjet që janë nënshkruar për t'u implementuar në të ardhmen, duke përfshirë marrëveshjet me institucionet komunale apo ato të nivelit qendror.

***h) Personi juridik ka afarizëm pozitiv në vitin e fundit fiskal;***

Personat Juridikë që aplikojnë për rilicencim, janë të detyruar që si pjesë e dosjes së tyre për licencim, të dorëzojnë një kopje të pasqyrave financiare të vitit të fundit fiskal. Komisioni për licencim, me rastin e vazhdimit të licencës duhet të marrë për bazë edhe gjendjen financiare të personit juridik në vitin e fundit fiskal. Fakti që personi juridik ka operuar me borxhe në fund të vitit fiskal, nuk duhet interpretuar si mospërmbushje e kësaj kërkese. *Komisioni duhet të analizojë edhe planin biznesor të paraqitur nga personi juridik, për të ardhur në përfundim nëse subjekti juridik do të jetë në gjendje të përmirësojë gjendjen financiare, konform planifikimeve të përcaktuara në planin e biznesit.*

***j) Nuk ka detyrime tatimore ndaj ATK-së apo ka marrëveshje për shlyerje të borxheve***

Në rast se subjekti aplikon për rilicencim, ky kriter duhet të plotësohet përmes dorëzimit të vërtetimit të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës që personi juridik nuk ka detyrime tatimore ndaj ATK-së, apo në rast se ka detyrime, të dorëzojë një marrëveshje me ATK-në lidhur me kryerjen e obligimeve tatimore. Në rastet kur personat juridik të sapo themeluar aplikojnë për licencim, nuk është e nevojshme dorëzimi i një vërtetimi të tillë.

***i) Ka përvojë dhe bashkëpunim me partnerë të fushës së shërbimeve sociale dhe familjare***

Aplikuesi për licencim, me rastin e dorëzimit të aplikacionit duhet të dorëzojë të gjitha marrëveshjet e bashkëpunimit me autoritetet publike apo subjekte e tjera, që dëshmojnë se ka përvojë në një apo më shumë fusha të ofrimit të shërbimeve sociale, për të cilat ka aplikuar për licencim.

## 2.5. Kriteret Teknike që duhet të përmbushin ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare

Bazuar në kërkesat e Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe të legjislacionit sekondar, ofruesi i shërbimeve sociale dhe familjare si person juridik duhet të plotësojë kushtet teknike në vijim:

***a. Personi juridik duhet të posedojë zyre për ushtrimin e aktivitetit***

Personi juridik duhet të posedojë zyre në të cilën ushtron aktivitetin si person juridik. Kjo nënkupton objektin, në të cilin personi juridik, mban dokumentacionin dhe mund të zhvillohen takime me klientët dhe autoritetet publike. Me rastin e aplikimit, personi juridik do të dorëzojë si pjesë të dosjes së aplikimit certifikatë pronësie për rastet kur zyra është në emër të personit juridik. Në raste tjera, duhet të dorëzohet dëshmi në formë të marrëveshjes së noterizuar për qira për zyrë për ushtrimin e aktivitetit (e njëjta dorëzohet si kopje e noterizuar).

b. ***Personi juridik duhet të posedojë ambiente të mjaftueshme, të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve dhe zhvillimin e aktiviteteve profesionale dhe rekreative për klientë***

Personi juridik duhet të posedojë ambiente të mjaftueshme, të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare dhe zhvillimin e aktiviteteve profesionale dhe rekreative për klientë. Kjo nënkupton objektin në të cilin personi juridik, i ofron shërbimet sociale dhe familjare dhe zhvillon aktivitetet me klientët. *Me rastin e aplikimit, personi juridik do të dorëzojë certifikatë pronësie, si pjesë të dosjes së aplikimit, për rastet kur zyra është në emër të personit juridik. Në rast se personi juridik nuk ka objekte në pronësi, duhet të dorëzohet dëshmi në formë të marrëveshjes së noterizuar për qira për objektin në të cilin do të bëhet ushtrimi i aktivitetit (e njëjta dorëzohet si kopje e noterizuar).*
Varësisht nga lloji i shërbimeve, sipas listës së llojit të shërbimeve dhe numrit të klientëve që do t'u ofrohet shërbim, personi juridik duhet të sigurojë hapësira të mjaftueshme të shfrytëzueshme për ofrim të shërbimeve të caktuara, në proporcion me numrin e klientëve dhe shërbimeve që do të ofrohen nga personi juridik që ofron shërbime sociale. Standardet e përcaktuara dhe të publikuara nga Ministria, përcaktojnë kërkesat sa i përket hapësirave për ofrim të shërbimeve specifike. Në lidhje me këtë kriter, duhet të plotësohen edhe kërkesat e tjera të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, dhe standardet ndërkombëtare sa i përket lokacionit, qasjes fizike për persona me nevoja të veçanta. Ambientet duhet të plotësojnë kushtet sanitare, të sigurisë, dhe pajisjeve adekuate sipas llojit të shërbimit që aplikohet për licencim. *Komisioni për licencim do të vlerësojë nëse për ofrimin e shërbimit të tillë, ambientet që ka personi juridik në dispozicion janë të mjaftueshme, adekuate dhe të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve të tilla për klientët, sipas standardeve për ofrimin e një shërbimeve të tilla dhe zhvillimin e aktiviteteve profesionale dhe rekreative për klientët.*

***c) Personi juridik duhet të posedojë pajisje adekuate për trajtimin dhe ofrimin e shërbimeve për klientët***

Ky kriter duhet të plotësohet në rast se për ofrimin e shërbimeve specifike për të cilat ka aplikuar personi juridik, kërkohet edhe plotësimi i kritereve shtesë për ushtrimin e një veprimtarie të tillë. P.sh. në rast se ofrohen shërbime të karakterit shëndetësor, duhet të sigurohen pajisjet adekuate për ofrim të shërbimeve të tilla për klientët. Me rastin e aplikimit, personi juridik duhet të dorëzojë një listë të të gjitha pajisjeve që ka në dispozicion, e që janë të nevojshme për ofrimin e shërbimit/shërbimeve të tilla sociale dhe familjare. Në rast se ofrohen shërbime për personat me nevoja të veçanta, gjithashtu duhet të sigurohen dëshmi për pajisjet adekuate për ofrimin e shërbimeve për klientët.
*Komisioni për licencim do të vlerësojë nëse për ofrimin e shërbimit të tillë, pajiset që ka personi juridik në dispozicion, janë të mjaftueshme dhe adekuate sipas standardeve për ofrimin e një shërbimi të tillë.*
*Varësisht nga lloji i shërbimit dhe numri i klientëve, aplikuesi duhet të sigurojë dëshmi se ka një minimumin të automjeteve transportuese të përshtatshme për ushtrimin e aktiviteteve dhe shërbimeve për klientët. P.sh nëse ofron transportin e personave me nevoja të veçanta.*

*Komisioni do të vlerësojë nëse ky kriter përmbushet varësish nga lloji i shërbimeve dhe nga numri i klientëve që personi juridik do iu ofrojë shërbime.*

## 2.5. Realizimi i aplikimit për licencimin e personave juridikë

Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 02/2020 për Licencimin e Organizatave Jo qeveritare dhe Subjekteve Juridike Private që Ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare, në nenin 14 ka paraparë edhe procedurën për aplikim, ndërsa në nenin 15 është paraparë mënyra e dorëzimit të kërkesës për aplikim.

- Aplikimi bëhet duke dorëzuar kërkesën për licencim dhe dokumentacionin përkatës të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ.
- Kërkesa për licencim i drejtohet Komisionit për Licencim, i cili vepron në kuadër të Ministrisë.

Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 02/2020 ka paraparë mundësinë e aplikimit në mënyrë fizike dhe në mënyrë elektronike. Neni 15, paragrafi 6 i Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2020, ka paraparë aplikimin në formë fizike, duke dorëzuar kërkesën e plotësuar dhe dokumentacionin e kërkuar në mënyrë fizike në Departamentin e Politikave Sociale dhe të Familjes, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ndërsa, sipas paragrafit 7 të të njëjtit nen, parashihet edhe mundësia e aplikimit në mënyrë elektronike, duke dorëzuar kërkesën përmes platformës elektronike dhe duke bashkangjitur dokumentet e kërkuara. Aktualisht është i mundur vetëm aplikimi në formë fizike, deri në momentin që Ministria të mund të krijojë një platformë elektronike përmes të cilës do të mund të dorëzohet aplikacioni dhe dokumentet e bashkangjitura në formë elektronike. Në momentin kur një aplikim i tillë do të jetë i mundur, Ministria do të publikojë në ueb-faqen e saj informacionin për mënyrën e aplikimit duke shfrytëzuar platformën e tillë elektronike.

## 2.6. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit për licencim të personave juridikë

Me rastin e aplikimit duhet të dorëzohet formulari i plotësuar i kërkesës, i cili është pjesë përbërëse e këtij Manuali. Aplikuesi duhet të specifikojë llojin e shërbimit/shërbimeve sociale dhe familjare, për të cilat aplikohet për licencim. Kërkesa duhet të jetë e kompletuar me gjithë informacionin e kërkuar në secilën pjesë të saj. Në formularin e kërkesës është bashkangjitur edhe një listë kontrolluese e dokumentacionit që duhet të dorëzohet, varësisht nga lloji i shërbimeve, të cilën aplikuesi e kontrollon para se të bëjë dorëzimin e aplikacionit.
Sipas Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 02/2020 për Licencimin e Organizatave Joqeveritare dhe Subjekteve Juridike Private që Ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare, kërkohet dorëzimi i këtyre dokumenteve:

*a) Kërkesa me shkrim, e plotësuar në formë fizike ose elektronike dhe e nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar (formulari i saj i bashkangjitur këtij Manuali);*

*b) Certifikata e regjistrimit të personit juridik në Ministrinë përkatëse (kopje e noterizuar);*

*c) Kopje të statutit të personit juridik, duke përfshirë edhe ndryshimet nëse janë të aplikueshme. Statuti duhet të jetë në përputhje me aktivitetet në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, për të cilat aplikohet për licencim;*

*d) Kopjet e licencave të ofruesve individual të licencuar nga KPSHSF-ja, minimumi i ofruesve individual dallon varësisht nga lloji i shërbimit që aplikohet për licencim (shih listën në aneks të këtij Manuali);*

*e) Certifikatë nga organi kompetent që subjekti juridik nuk është në shuarje dhe falimentim - origjinali ose kopje e noterizuar;*

*f) Certifikatë nga gjykata kompetente që personi juridik nuk është në procedurë nën hetime. Certifikata duhet të jetë jo më e vjetër se 30 ditë para datës së aplikimit - origjinali ose kopje e noterizuar;*

*g) Kopja e planit të biznesit tre vjeçare (Modeli i bashkangjitur këtij Manuali);*

*h) Deklaratat e nënshkruara nga secili ofrues individual, se pajtohen të ofrojnë shërbime për personin juridik në rast se licencohet (origjinale) dhe kontratat e tyre të punës – kopje, (formulari i deklaratës bashkangjitur në aneks të këtij Manuali);*

*i) Marrëveshje bashkëpunimi mbi zbatimin e projekteve në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare - kopje; (e detyrueshme me rastin e aplikimit për rilicencim);*

*j) Pasqyrat financiare të vitit të fundit fiskal, kopje;*

*k) Vërtetim apo marrëveshje nga ATK-ja lidhur me kryerjen e obligimeve tatimore - kopje; (Nuk është e aplikueshme për personat juridikë që janë themeluar rishtas dhe aplikojnë për licencim për herë të parë, ndërsa është e detyrueshme me rastin e aplikimit për rilicencim);*

*l) Letër rekomandim nga partnerët që ka marrëveshje bashkëpunimi, ose ka pas marrëveshje bashkëpunimi - kopje;*

*m) Certifikatë pronësie ose marrëveshje të noterizuar qiraje për zyrë për ushtrimin e aktivitetit (kopje e noterizuar);*

*n) Certifikatë pronësie, kontratë qiraje, dhe/apo dokument tjetër me të cilën dëshmohet posedimi i hapësirave (duke përfshirë m2 ) të mjaftueshme, dhe të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve dhe zhvillimin e aktiviteteve profesionale dhe rekreative për klientë sipas llojit të shërbimeve (kopje e noterizuar); (e detyrueshme për atë lloj të shërbimeve sociale dhe familjare ku kërkohet të ketë ambiente për ofrim të shërbimeve përkatëse sociale dhe familjare);*

*o) Listën e pajisjeve adekuate që ka në pronësi ose posedim për trajtimin dhe ofrimin e shërbimeve për klientë, të dorëzuar në formë të një deklarate të nënshkruar nga udhëheqësi i personit juridik; (e detyrueshme për ato shërbime sociale për të cilat kërkohet posedimi i pajisjeve për ofrimin e shërbimeve të tilla, apo realizimin e aktiviteteve profesionale apo rekreative me klientë);*

*p) Kopjen e librezës së automjetit/automjeteve, apo kontratë qiraje (në rast se kërkohet për një lloj të shërbimit që aplikohet për licencim);*

*q) Kopjen e fletëpagesës që vërteton pagesën e taksës administrative të aplikimit;*

*r) Aplikuesi mund të dorëzojë edhe dokumente tjera shtesë, në rast se konsideron se ato janë të rëndësishme për procesin e licencimit.*

## 2.7. Roli, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit për Licencim

Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 02/2020, në nenin 7 ka paraparë në detaje përbërjen, mënyrën e themelimit, rolin dhe detyrat e Komisionit për Licencim. Rrjedhimisht, Komisioni themelohet si Komision me mandat trevjeçar me mundësi vazhdimi. Komisioni për Licencim, zhvillon procedurë administrative e cila zhvillohet sipas kërkesës së palëve. Çdo kërkesë për licencim shqyrtohet në procedurë administrative nga Komisioni, dhe për të njëjtën merret vendimi brenda 30 ditësh. Komisioni për Licencim është organi i vetëm përgjegjës për shqyrtimin e aplikacioneve.
Për themelim të komisionit për licencim, Departamenti përkatës, propozon tre zyrtar të DPSF-së dhe njëkohësisht kërkon nga OJQ-të dhe QPS-të, delegimin e përfaqësuesve të tyre duke u bazuar në kushteve dhe kritereve të përcaktuara në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2020. Komisioni duhet të ketë përbërje të tillë që reflekton profesionalizmin dhe përbërjen e kërkuar me nenin 7 të UA Nr. 02/2020.
Me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm themelohet një komision AD-HOC, i cili do të vlerësojë dokumentacion për anëtarët e propozuar nga institucionet dhe subjektet përkatës. Komisioni AD HOC bënë vlerësimin dhe i propozon Sekretarit të Përgjithshëm listën me kandidatët, ndërsa Sekretarit të Përgjithshëm nxjerr vendim për themelimin e komisionit.
Ministria njofton institucionet përkatëse dhe anëtarët me përbërjen e komisionit, përmes mjeteve elektronike të komunikimit.
Ministria njofton institucionet përkatëse dhe anëtarët me përbërjen e Komisionit, përmes mjeteve elektronike të komunikimit.

## 2.8. Roli, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit të Ankesave

Komisioni për Ankesa i themeluar me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm, ka për detyrë të shqyrtojë çdo ankesë të subjekteve juridike kundër vendimit të Komisionit për Licencim.
Ankesat parashtrohen dhe trajtohen sipas kërkesave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Ankesat parashtrohen brenda 30 ditësh, nga dita kur pala ka pranuar vendimin e Komisionit për Licencim. Ankesa duhet të tregojë në mënyrë të qartë pretendimet ankimore ndaj vendimit të Komisionit për Licencim.
Të njëjtat rregulla që kanë të bëjnë me parandalimin e konfliktit të interesit, të cilat aplikohen për Komisionin për Licencim, aplikohen edhe për Komisionin e Ankesave.

## 2.9. Licenca dhe vazhdimi i licencës

Përmbajtja e licencës, afatet e vlefshmërisë dhe çështjet e tjera rreth licencës, janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar me UA.
Sa i përket vazhdimit të licencës, Komisioni për Licencim ndjek të njëjtën procedurë me rastin e aplikimit për përtëritjen e licencës, rrjedhimisht, zbatohet e njëjta procedurë vendimmarrëse.

- Kërkesa për vazhdim duhet të dorëzohet jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të afatit të vlefshmërisë së licencës ekzistuese.

- Së bashku me kërkesën për vazhdim të licencës, dorëzohen dëshmi dhe raporte për shërbimet që i ka ofruar personi juridik gjatë periudhës së vlefshmërisë se licencës, si: letër rekomandim/et, marrëveshjet e bashkëpunimit dhe raportet e aktiviteteve të zhvilluara dhe shërbimet e ofruara.
- Komisioni për Licencim bën verifikimin, duke përfshirë edhe vizitën në terren nëse është e nevojshme për të konstatuar përmbushjen e kritereve teknike.
- Komisioni duhet të marrë parasysh edhe raportin e monitorimit apo inspektimit, nëse gjatë periudhës së posedimit të licencës ka pas monitorim apo inspektim.

Komisioni mund të vendosë për vazhdim të licencës ekzistuese, refuzim të vazhdimit të licencës, apo dhënie të licencës së kufizuar bazuar në raportin e monitorimit apo inspektimit.

## 2.10. Revokimi i licencës

Revokimi i licencës mund të ndodhë për shkak të shkelje të legjislacionit në fuqi, standardeve minimale dhe të kodit etik për shërbime sociale dhe familjare, që dëshmohet me raportin e monitorimit apo inspektimit. Licenca tërhiqet me vendim të Komisionit për Licencim.
Revokimi i licencës nënkupton se personi juridik nuk i përmbush kriteret ligjore ose teknike për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, dhe nuk mund të ushtrojë veprimtari në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare pa një licencim të ri.
Në rast revokimi të licencës, aplikimi për licencim mund të bëhet vetëm pas kalimit të afatit prej 6 muajsh nga vendimi për tërheqje të licencës, vetëm në rast se janë eliminuar parregullsitë, shkeljet ligjore dhe profesionale, të cilat duhet të konstatohen me raportin që ka bërë monitorimin ose inspektimin, apo me vendimin e autoritetit përkatës, varësisht ku është iniciuar procedura

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera*
*Ministry of Finance, Labour and Transfers*

---

# Lista e shërbimeve sociale dhe familjare për licencim të ofrueseve nga sektori joqeveritar dhe privat, duke përfshirë minimumin e ofrueseve individual dhe hapësirës minimale për ushtrimin e veprimtarisë

| Nr. i shërbimit | **Emërtimi dhe lloji i shërbimeve sociale dhe familjare për licencim** | **Minimumi i ofruesve individual të shërbimeve sociale dhe familjare** | **Minimumi i hapësirës për ushtrimin e veprimtarisë së subjektit juridik** |
|---|---|---|---|
| 1. | Strehim dhe shërbime për mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror. | Nivel nacional:<br>Profesional - 2 ☐<br>I mesëm - 1 ☐ ose I lartë - 1 ☐<br>Bazik - 3 ☐ | 48 m² |
| | | Nivel lokal:<br>Profesional - 1 ☐<br>I mesëm - 1 ☐ ose I lartë- 1 ☐<br>Bazik - 2 ☐ | 32 m² |
| 2. | Strehim dhe shërbime për mbrojtjen e fëmijëve të abuzuar, keqtrajtuar, të lënë pas dore dhe fëmijë viktima të trafikimit, në nivel të ulët të rrezikut. | Nivel nacional:<br>Profesional - 2 ☐<br>I mesëm - 1 ☐ ose I lartë - 1 ☐<br>Bazik - 3 ☐ | 48 m² |
| | | Nivel lokal:<br>Profesional - 1 ☐<br>I mesëm - 1 ☐ ose I lartë - 1 ☐ | 32 m² |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Bazik - 2 ☐ | |
| 3. | Strehim dhe shërbime të kujdesit për fëmijë në punë të rënda dhe të rrezikshme. | Nivel nacional:<br>Profesional - 2 ☐<br>I mesëm - 1 ☐ ose I lartë - 1 ☐<br>Bazik - 3 ☐ | 48 m² |
| | | Nivel lokal:<br>Profesional - 2 ☐<br>I mesëm - 1 ☐ ose I lartë - 1 ☐<br>Bazik - 1 ☐ | 32 m² |
